

VENDIM
Nr. 147, datë 24.4.2023

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK SI MJET (BARRË SIGURUESE) PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ “GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEAST EUROPE S.A., SICAV-SIV”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 8, 9, pikat 4 dhe 5, dhe 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1134/1 prot., datë 20.4.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimit ndaj “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., Sicav-Siv”,

konstatoi se:

- Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1134 prot., datë 27.3.2023, ka paraqitur kërkesën për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., Sicav-Siv”.

- Shoqëria është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022.

- Rezulton se shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k., plotëson kërkesat si vijon:

- Neni 8, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”.

- Neni 8, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”.

- Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pika 1 dhe 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”.

- Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa i përket pagesave rregulatore.

- Kontrata e nënshkruar me MIE-n nr. 2720 rep., nr. 2066 kol., datë 9.7.2021, e depozituar në ERE nga shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k., në kuadër të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nuk përmban detyrimin për miratimin/njoftimin e autoritetit shtetëror për shoqërinë, por si dhe në raste analoge, ERE do të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e organit shtetëror të autorizuar në lidhje me dhënien e këtij autorizimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimit ndaj “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., Sicav-SIV”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti